



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 435/9 Prot.

Tiranë, më 19.07.2019

V E N D I M

Nr.87, Datë 19/07/2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONET NË VARËSI TË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, AGJENCIA KOMBËTARE E
ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 34, datë 19.04.2019, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 435/1 prot., datë 19.04.2019, të miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr. 435/2 prot., datë 19.04.2019, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, i është njoftuar subjektit fillimi i procesit.

Subjekti i mbikëqyrur përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e materializuar edhe në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 14), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr.nr.435/5, prot., datë 10.06.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 5 ditë kohë, për të paraqitur observacionet në lidhje me gjetjet e përfshira në këtë material.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 122/2 prot., datë 17.06.2019, “Observacionet e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional dhe Kualifikimeve ndaj Projektraportit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e varësisë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgatitur nga grupi i mbikëqyrjes i Komisionerit për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 435/8/1 prot., datë 19.06.2019, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka dërguar disa komente dhe shpjegime, të cilat janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe janë analizuar dhe trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, duhet të unifikojë kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë (*në rastin konkret për pozicionin e punës “Drejtor Drejtorie” dhe “Përgjegjës Sektori”*) në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ky proces duhet të realizohet duke vlerësuar përfshirjen e tyre në një prej kategorive të përcaktuara në këtë dispozitë: e lartë drejtuese, e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive, me qëllim rritjen e transparencës si në drejtim të procesit të rekrutimit (*në nivel ekzekutiv, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë*) ashtu edhe në drejtim të mënyrës së pagesës së nëpunësit civil, në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat që ai realizon gjatë veprimtarisë së tij.

3. Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit, si njësi përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, duke e vijuar këtë proces si më poshtë:

- Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
 - Pas marrjes së konfirmimit nga njësi përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja“c”, të VKM nr.142, datë 12.3.2014, i ndryshuar.
 - Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
4. Për të rregulluar situatën e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e mbikëqyrur, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 2010/1, datë 22.02.2018, me anë të të cilit, nëpunësja *****, është ngarkuar për ushtrimin e detyrës si Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe të rikthehet në pozicionin e saj të mëparshëm të punës, *“Përgjegjës i Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale”*, në Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Institucioni duhet të kërkojë nga Departamenti i Administratës Publike, që pozicioni i punës *“Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”* të plotësohet sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

5. Departamenti i Administratës Publike, të marrë masa për ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve me qëllim që stafi TIK i institucionit, ku parashikohet pozicioni i punës *“Specialisti për Teknologjinë e Informacionit (IT)”*, të kalojë si pjesë e strukturës të AKSHI-it, në zbatim të Vendimit nr.673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*.
6. Të anulohen aktet administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2018, sipas detyrave të lëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të fillojë procesi i vlerësimit nga e para.

Me qëllim përmbushjeve detyrimeve në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, njësi përgjegjëse (DAP), duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- Pozicioni i punës Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve/Titullari i institucionit, i cili paraqitet në të njëjtën kohë në rolin e zyrtarit autorizues dhe kundërfirmues, të plotësohet sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me qëllim që të ketë kompetencat për të kryer këtë veprim administrativ.
 - Në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr.109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga nëpunësit përgjegjës duhet të përfundojë vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2018, si dhe të respektohet procedura dhe afati edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2019.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
 8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 10. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA